

Në bazë të nenit 164, 165, 166, 172 dhe 176 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.178/21), nenit 23 të Ligjit për Marrëdhënie Pune (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014; 20/2015; 33/2015; 72/2015; 129/2015; 27/2016, 120/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.110/19, 267/20, 151/21 dhe 288/21), Rregullores për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirrje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, shpall:

## KONKURS

### Për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore – shkencore pranë Fakulteteve të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

#### A. FAKULTETI I SHKENCAVE INFORMATIKE

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore **Intelegjenca artificiale dhe sistemet (21205)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

#### B. FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore **Menaxhimi me burimet njerëzore (50622)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.
2. Zgjedhje të dy mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore **Administrimi publik (50901)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.
3. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore **Kineziologji e aplikuar (sport, edukim fizik, rekreim, kinezioterapi dhe tjetër) (50401)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.
4. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore **Tjetër (50403)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

#### Kushtet dhe kriteriumet për zgjedhje:

Kandidatët duhet të plotësojnë e kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Ta njohë mirë gjuhën maqedone,
- Të jetë në moshë madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Të mos ketë vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim ndalesë të kryerjes së profesionit veprimi apo detyrës.

Përpos plotësimit të kushteve të përgjithshme të lartëpërmendura, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet dhe kriteriumet të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirrje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

#### Kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitje për konkurim,
- Biografi të shkurtë-CV,
- Certifikatën e shtetësisë,
- Vërtetim për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës – Vërtetim mjekësor,
- Vërtetim se nuk ka vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim ndalesë të kryerjes së profesionit veprimi apo detyrës.
- Dëshmi për njohje të njëjës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, frënge, gjermane).

- Diplomën dhe certifikatën e notave për të dy, përkatësisht të tre ciklet e përfunduara të studimit (nëse arsimit është kryer jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut të bashkangjitet dëshmia për nostrifikim dhe ekuivalenca e notave),
- Listë me punimet shkencore dhe profesionale dhe nga një egzemplar të punimeve shkencore dhe profesionale si dhe
- Vendim për përzgjedhje të mëparshme në thirrje mësimoro-shkencore

Orari i punës do të përcaktohet në përputhje me orarin e orëve mësimore dhe akteve të Universitetit.

Shuma e pagës bazë neto për këto pozicione është në përputhje me aktet e Universitetit, angazhimin mësimor të mësimdhënësit në semestër dhe titullit mësimor dhe shkencor në të cilin bëhet përzgjedhja, edhe atë për dy pozicionet para duke filluar nga 39.068 deri në 46.144 denarë.

Konkursi zgjat **pesë (5) ditë pune** nga dita e shpalljes së konkursit, dhe zgjat **deri me datë 04.07.2022**. Fletëparaqitjen me dokumentet kandidatët duhet ti dorëzojnë në hapsirat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rr.”Mirçe Acev” nr.4/ kati i VII-të, me dedikim: Për konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimoro –shkencore, në:

**A. Fakultetin e Shkencave Informatike**

**B. Fakultetin e Shkencave Sociale**

**pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**

Dokumentet jo të kompletuara dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të shqyrtohen.

Kontakt numri: 02/3161-004

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup